



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kacanik**  
**Municipal of Kacanik**

**01Nr.60/01-16918/25**  
**Kaçanik, 29.07.2025**

## **PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e **VII (shtatë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2025 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 29.07.2025. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës të kësaj mbledhje ishin 25 anëtarë. Në mbledhje munguan me arsyé 2 anëtarë: Betim Shala dhe Besnik Salihu.

Nga Ekzekutivit i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës -Besim Ilazi, Nënkyetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtori et drejtore: Qamil Stagova-DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Zahir Doda-DA, ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës ishin: Valdrin Dogani-ZKF, Burim Bajra, Hajredin Shehu, Fatlume Guri-Selimi- Zyra e Informimit, Bejtulla Dalloshi- Zyra e IT, Mavije Murseli-Zyra e Kryesuesit, Makfire Malsiu-Zyra e KK.

Mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj- zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit  
 Procesmbajtës, Makfire Malsiu - Zyrtare e lartë për punë të KK.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli:** Se pari iu përshëndes të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, prezantë janë 25 anëtarë, 2 anëtarë mungojnë me arsyé, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, vazhdim e hapi mbledhjen e shtatë (7) të rregullt të KK për vitin 2025, data 29 korrik 2025, me këtë:

### **REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhën: Janar-Qershori 2025;
3. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2024;
4. Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për PFV 2024;
5. Raporti Gjashtëmujor i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2025;
6. Propozim Vendimi për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për komunën e Kaçanikut;
7. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit të KK për shpallje me interes publik të parcelës kadastrale 00515-1 në ZK Kaçanik.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutimin nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezent 25. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës

**Aprovoj**

**Rendin e punës prej 7 pikave.**

## 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për vërejtje në procesverbal nuk u paraqit kush, atëherë Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezent 25. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

### Aprovoj

**Procesverbalin e mbledhjes së VI (gjashtë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës, të datës 30.06.2025/Lënda: 01Nr.060/01-14024/25.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Konstatoj me kaluar në pozicionin e pyetjeve dhe kërkesave, nga IT po me njoftojnë se ka pak një problem teknik incizimi i mbledhjes, vazhdojmë se nuk e di a po i tejkalojmë problemet e incizimit.

### Pyetje dhe Kërkesa

**zpj. Ardita Rahmani:** Është shumë keq që nuk po bënë incizimi. Jam e obliguar me incizuar vet personalisht, për me dërguar mesazhin aty ku duhet.

1. Nuk e kam menduar që në seancën e parafundit, nuk me duhet me paraqitur kërkesa tjera, përpos asaj kryesore, çështjen e ujit të pijes, problem ky i cili është i kahershëm, që 25 vite, ndërkaq në këto 4 vitet e fundit jemi duke u ballafaquar jashtëzakonisht keq, vështirë po ia dalim. Ky mesazh i imi sot, vjen prej grave, nënave të kësaj komune që janë në shtëpitë e tyre, janë detyruar me qëndruar aty me i duruar erërat nga kundërmimet nga pastërtitë në kuzhinë, tualete, në mungesë të ujit. Më vjen shumë keq nëse qëndroni indiferent kundrejt kësaj situate. E di se ekziston vullneti të secili anëtar i KK, për me i dhënë zgjidhje, por nuk jeni duke e bërë. A e dini sot sa fëmijë janë në komunën e Kaçanikut, që nuk kanë ujë për pastrimin e duarve kur luajnë, sa fëmijë të tjerë janë që kanë mungesën e ujit të pijes, e detyrohen me blerë ujë? A e dini sa të moshuar, janë që nuk munden me i mbulua nevojat e tyre me ujë të pastër? Kjo thirrje e imja është për institucionet komunale dhe Bifurkacionin. E di sa ka vullnet për me zgjidhur këtë çështje, por nuk po zgjidhet. Është e turpshme për krejt neve që jemi përgjegjës që nuk po mundem me i bërë zgjidhje këtij problemi. Në shenjë proteste, të cilën kurrë ky KK nuk e ka bërë për 4 vjet, unë i kam marrë disa shishe të zbrazura, të cilat shishe të zbrazura sot i gjënë në secilën shtëpi në komunën e Kaçanikut. Ky është turp i cili na mbulon të gjithë neve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ju njoftoj se tanë jemi në rregull me transmetimin.

**zpj. Ernseta Krasniqi:** Edhe unë sot flas për një problem ky i cili prek çdo qytetarë të komunës së Kaçanikut. E kam shumë të vështirë të pranoj sot në vitin 2025, në këto temperaturat kaq të larta, ende përballemi me problemin e ujit të pijes. Ky nuk është një problem i ri, kemi folur për këtë problem çdo vit, vit pas viti të këtij mandati, edhe në mandatin e kaluar, ndërkaq nuk është marrë asnjë hap me bërë zgjidhje, vetëm fjalë e pretime. Kërkoj nga kryetari mos të mundohet me shfajësuar, me thënë jo kompetencat, jo drejtori, se nuk ka asgjë që iu shfajëson prej pretimeve të rrejshme që i keni bërë. Me lejoni me i cituar disa pretime të kryetarit:

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ju lutem, parashtroni pyetje konkrete Ernesta.

**zpj. Ernseta Krasniqi:** Me 12 tetor 2017, kandidati nga PDK Besim Ilazi ka thënë se ka propozuar një projekt, deri në 70 % të qytetarëve të komunës do të kenë furnizim me ujë.

Me 8 nëntor 2021 në fushatë elektorale, ka premtuar një projekt: Ndërtimin e një fabrike për ujin e pijes në Sepetin- Dubravë, do të jetë një ndër premtimet për mandatin e ardhëm, premtim me prioritet kryesore për juve për investime kapitale. Investimet për ujësjellës janë në mesin e prioriteteve kryesore të IK. Periudha 4 vjeçare 2022-2025, dështoj në realizimin e projektit dhe zgjidhjen e problemit të ujit të pijes.

**Kryetari i Komunë-Besim Ilazis:** Projekti është duke ndenjur në ministri. E dimë se jemi në fushatë.

**z. Kadri Krivenjeva:** Kërkoj nga Kryesuesi i KK t'ia ndalë fjalën, se e keni të drejtën, se jemi të pyetjet dhe kérkesa, ose e bëjmë këtë temë çështje e debatit, se jemi bërë ma zi se në Gaza.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ernesta, a bënë me ndërprerë diskutimin, të jeni me konkret në pyetje dhe kérkesa?

**znj. Ernseta Krasniqi:** Është ligj kryetar me dal me deklaratë, se kur po vjen puna me bërë zgjidhje konkrete, heshtni. E kam thënë edhe disa herë se nuk keni vizion, keni vetëm fjalë, propagandë, por jo investime reale. A e keni pa shpime në Sepetin, sa metra janë hapur, pyetja ime është, a ka dalë uji? Dikur kanë qenë gypa me kapacitet me të madh, f200, i keni hequr, i keni vendosur gypa f 175.Ju e keni problemi e vetëm me dhënë leje ndërtimi, ndërkaq keni harruar që keni zvogëluar kapacitetet për ujësjellës.

**Kryetari i Komunës:** Nuk po të kuptoj pyetjet se shumë të gjata, po na mban ligjërata, unë po dal njëherë, kur ta kryen (Ernesta) me thirrni.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Konkretizoje pyetjen Ernesta.

**znj. Ernseta Krasniqi:** Del (Kryetar) se nuk mundesh me u përballë me premtimet e juaja. Qytetarë të dashur, kryetari i komunës tonë heshtë, nuk mundet me iu dalë përballë premtimeve që ka rrejtur, bash ka rrejt.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ernesta, kujdes me fjalorin, përndryshe mundeni me dal jashtë.

**znj. Ernseta Krasniqi:** Po iu dhimbën mjetet me investuar në ujësjellës, por nuk po iu dhimben me investuar për një park për tre herë, në vlerë gjysmë milioni euro, e jo me zgjidhur problemin e ujit të pajes njëherë e përgjithmonë, me pasur ujë qytetarët e komunës së Kaçanikut. Është mirë kryetar me ndenjur këtu se vet ke premtuar dhe është mirë me dhënë llogari për premtimet, lë të del këtu e të fol, e jo me ikur.

**Kryetari i Komunës:** Për këtë temë, mundemi të diskutojmë, tani jemi të pyetjet dhe kérkesat.

**znj. Ernseta Krasniqi:** Kryetar, ju i keni lënë qytetarët pa zgjidhje të problemit, me mirë ecë.

**z. Kadri Krivenjeva:** Kush jeni ju me i thënë kryetarit ecë.

**Kryetari i Komunës:** Selajdini e ka fjalën, Rrustem nëse keni diçka, mundeni me dalë jashtë me zhvilluar debatin.

**z. Selajdin Troni:** E falënderoj Arditën që ka kérkuar me formuar një komision. Në atë komision kanë qenë: Agim Mani, Rrustem Zenuni, Kemajl Murseli, Ardita Rrahmani.

**znj. Ardita Rrahmani:** Kur është formuar ai komision, nuk ka komision të formuar.

**Nënkyetari i Komunës:** Nëse doni me qenë në rend pune çështja e ujit të pajes vendosni, përndryshe keni dalë jashtë rendit të punës.

**z. Selajdin Troni:** A keni bërë zgjidhje si komision, a keni shkuar me u takuar me drejtorin e Bifurkacionit? Drejtori na ka shpjeguar se e kemi pusin të gëlqerja, por nuk e kanë vënë në funksion. Arditë, ku është raporti, që ia ka dhënë drejtori i Bifurkacionit njësia në Kaçanik, se uji ka shkuar në institut për analiza, uji ka dalë i pijshëm. Komuna ka investuar në gypa, është bërë shtrirja e gypave në fshatra.

**Kryesuesi i Kuvendit:** A po e dini se në cilin vend jeni?

**znj. Ardita Rrahmani:** Përmirësoje (Selajdin) se nuk ka qenë komision, por përfaqësues nga subjektet politike dhe unë kur kam kérkuar me u diskutuar kjo çështje në KK, gjysma e anëtarëve të KK nuk kanë qëndruar në sallë. Unë kam qenë njëra prej tyre që kam kérkuar takim, kam shkuar të zyrat e tyre. Jam ajo që kam folur në këtë KK, që nuk është mënyrë e duhur dhe komunikim i duhur. Unë jam tepër falënderuese nënkyetarit dhe kushdo që është përgjegjës për takimin e mbajtur me 09 prill, ku ka marrë pjesë kryeshefi i Bifurkacionit dhe ai i njësisë në Kaçanik, në atë takim kanë qenë përfaqësuesit e subjekteve politike. Në po të

njëtin takim, që besoj se ka procesverbal, që unë nuk e kam, ku në atë takim të njëjtën pyetje e kam bërë. Protesta ime sot, është kundrejt atyre që janë përgjegjës.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ka qenë iniciativë e grupeve të përfaqësuara në KK. Ne këtë temë e kemi shterë. Nëse ka pyetje tjera, urdhëroni, nëse jo kalojmë në pikën vijuese. Për cilën do temë që jeni të interesuar, mund të kérkonit të fusim në rend pune. Ju lutem të jeni konkret, mos të tejkalojmë atë për të cilën jemi thirrur.

**z. Naim Beça:** 1. Zakonisht na vijnë emailiet me pyetjet dhe përgjigjet, ndërkaq këtë herë nuk kemi marrë. Pyetjet i kemi bërë para 1 muaji, përgjigje nuk kemi marrë. Njëra prej pyetjeve ka qenë: A është bërë ekspertiza e ujit të fabrika e gëlqeres, kemi diskutuar në janar 2025 ? A është raporti? Keni pas premtuar se ujin do të dërgojmë për të dytën herë për analiza, për çështjen e mangamit, përgjigjen të cilën e kam ngritur nuk ka ardhur.

**Nënkyetari i Komunës:** Mundemi me iu përgjigjur tani përritjen e vlerave të mangamit, se jam në rrjedha të çështjes.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Përgjigjen të jep nënkyetari.

**z. Kadrije Lika-Troni:** Përgjigjet na jepni me shkrim.

**z. Naim Beça:** E keni harruar titullin që kemi ne 27 anëtarë të KK. Ne jemi këshilltar të KK dhe nëse është fjala për diçka, ne japim këshilla, se vet fjala këshilltar, japim këshilla për mos me gabuar pushteti. Ne gjithmonë kemi bërë kérkesa dhe kemi këshilluar, kështu mos na i ndërprenë fjalën nëse këshillojmë çështje. Si këshillë, nuk ka drita tërë verën këtu në korzën e 4, nuk ka drita të bulevardi i Kaçanikut.

2. Rrugët e Bulevardi janë të pa pastruara ka kohë të gjatë, kantat e mbeturinave janë përmjericë. Duhet të jemi me të përgjegjshëm bile sa të jenë këtu mërgimtarët.

3. Çështja e ujit të pjes, që 4 vjet është kjo temë, nuk është marrë ndonjë veprim përzgjidhje. Ju lutem, bëni diçka, bëni ndonjë deklaratë që të dimë se çka është në pyetje, se me të vërtetë jemi në pozitë të keqe.

**z. Agim Çaka:** Pajtohem me shqetësimin që u ngrit për çështjen e ujit, pa dashur me diskutuar me tepër. Ne këtu nuk jemi me përcaktuar fajtorin, por ne e bëjmë në formë demonstrative zgjidhjen e këtij problemi përmes përfunduar me shkurt këtë çështje.

2. Rruja përmes Runjevës, që sa kohë ka filluar meremetimi i kësaj rruge, ka ende gropat e hapura në pjesë të rruget, kur pritet të përfundoj sanimi i këtyre gropave? A parashihet vetëm sanim i gropave, apo edhe ndonjë pjesë asfalti në këtë rruge? Rruja është në gjendje të mjerueshme, ankesat e qytetarëve që frekuentojnë atë rruge janë të mëdha.

**z. Agim Mani:** Po ndërlidhem me diskutimin e Selajdinit i cili theksoj se është formuar një komision, nuk ka pasur komision të formuar, ka qenë nga shefat e GP dhe drejtori i DSHPE, dhe Nënkyetari, ku e kemi diskutuar gjë e gjatë problemet e mungesës së ujit të pjes. Pavarësisht se drejtori i DSHPE nuk është këtu, këta tjerët thonë mos e diskutoni këtë temë. Kjo temë është aktuale, se në çdo shtëpi, lagje, qytet, debatohet përmes ujës, e ne nuk e shohim të arsyeshme të debatojmë këtë temë. Ne kérkojmë të dimë ku ka mbetur çështja, drejtori ku është, drejtori ka dhënë dorëheqje, është lehtë me dhënë dorëheqje, por qytetarët kanë mbetur pa ujë. Kérkojmë sqarim me të detaujar se ku ka mbetur çështja e ujit?

**z. Arta Avdiu:** I kam 2 kérkesa përmes DSHPE:

1. Shprehi shqetësimet e mia përmes gjendjen e varrezave në qytetin e Kaçanikut, që janë në gjendje të mjeruar. Aktualisht varrezat janë në gjendje të mjerueshme, të mbuluara me bari e baltë, mbeturina të shumta, gjë që dëmton pamjen e qytetit dhe ndjenjën e respektit përmes ndjerit tanë. Duke qenë se këto varreza janë vendi i parë që sheh në qytet çdo vizitor, kjo gjendje lënë përshtypje shumë të keqe dhe nuk përfaqëson vlerat përmes komunitetit. Kérkoj mirëkuptim që

komuna në bashkëpunim me kompaninë përkatëse të merr veprimet e nevojshme. Besoj se veprimet e tillë janë në të mirë të mbajtjes së rendit dhe pastërtisë publike, por edhe për respektimin e ndjenjave të banorëve dhe vizitorëve tanë.

**z. Burim Shehu:** 1. Në rrugën “Besnik Begunca” nuk ka fare trotuar. Ju kisha lutur se është kërkesë e qytetarëve me bërë pengesa në rrugë, se automjetet zhvillojnë shpejtësi, me çka rrezikojnë fëmijët dhe qytetarët që kalojnë në atë rrugë.

2. Të rruga “Mejdi Dalloshi” në drejtim të rrugës “Zija Bela”, janë 4-5 shtëpi që ia keni premtuar një shkarpë, por nuk është bërë. Nëse ka mundësi me sqaruar pse nuk është realizuar ky projekt, se janë bërë matje, ata janë në rrezik. Kërkoj me më kthyer përgjigje në këto kërkesa, se janë shumë të nevojshme.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Meqë drejtori i DSHPE nuk qenka, shpresoj se na jep dikush përgjigjet, që mos t'i përsërisim më kërkesat tonë. Kujt duhet me iu drejtuar për përgjegjësitë e kësaj drejtorie, juve kryetar apo nënkyetarit?

**Kryetari i Komunës:** Drejtorisë i drejtohesh.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** 1. Tani që mërgata është këtu, nuk kemi ujit të pijes.

2. Sheshi i qytetit, kundërmon nga dy anët, në njëren anë nga tualetet në anën tjetër nga nerodimja.

3. Shenjëzimet - zebrat mungojnë në qytet, me çka rrezikohet çdo qytetar në trafik.

4. Një freski që e patëm të “qeshma” e hoqët, që në këtë pikë të vapës kishte qenë shumë e dobishme për qytetarët, e jo qytetarët me blerë ujë e me pirë, por ishin freskuar aty, sikurse jemi freskuar gjatë gjithë jetës deri me tani.

5. Deri me tani, nuk është bërë dezinfektimi dhe dezinsektimi në këto temperaturat të larta, nuk e di a planifikohet me u bërë.

6. Tani është filluar me drejtorë në ikje të përgjegjësive dhe krejt pushtetit në ikje.

**Nënkyetari i Komunës- Sabedin Vishi:** E ndiej për obligim, edhe pse nuk ishte konkrete forma e pyetjeve, se ju bëtë raport, menduam se po kërkon me qenë në rend pune për diskutim, por nuk këruat.

**znj. Arditra Rahmani:** Nënkyetar, kërkoj të shtrohet në votim.

**Nënkyetari i Komunës- Sabedin Vishi:** Nuk e kërkoj askush me u diskutua, çështja e ujit të pijes.

**Kryesuesi i Kuvendit:** U debatua kjo çështje, nuk pati kërkesa për me qenë në rend pune.

**Nënkyetari i Komunës:** Sa i përket çështjes së ujit, është e vërtetë se kemi pasur problem edhe në vitin e kaluar, e kemi ngritur si shqetësim edhe ne edhe ju. Në vitin e kaluar e kemi pasur një takim me ISHP ku kanë marrë pjesë doktor Lul Raka dhe të MSH, drejtori i shërbimeve publike dhe drejtori i Bifurkacionit, Jeton Shabani dhe me përgjegjësin e njësisë në Kaçanik, Mustafë Shehu. Dhe janë zotuar se para qershoret ka me u instaluar një mekanizëm për zvogëlim të mangamit që me futur në funksion pusin e gëlqeres, që e zgjidhë problemin e ujit në qytet. Pas kësaj, kemi dërguar emaile me kohë përmes drejtorit, tani drejtori nuk është këtu, për zotimet e bëra për mekanizëm, por ende nuk është vënë në funksion. Puset tjera alternative, të Koxhajt, Kaçanik të Vjetër, të uji nxeh të dhe 2 gypa janë në Rekë - Dubravës, për 6 fshatra, të cilët me një ventil, e lëshojnë ujin për krejt, por nuk po lejojnë një gjë të tillë, se uji është sipërfaqësor. Ne kemi kërkuar në f. nga vijë unë, se edhe atje ka problem, që në pikun e zhegut kur janë edhe bashkatdhatarët, me nënshkrime lë ti lëshojnë krejt këto burime, me një njoftim se uji nuk është për pije. Nuk është zgjidhja me e mirë, po me e mirë se kjo është, por nuk e marrin përgjegjësinë për zgjidhje, se nuk guxojnë- sipas Bifurkacionit. Në muajin prill, sipas kërkesës së Arditës e kemi pasur një takim me Bifurkacioni, këtu e

përmirësoj Selajdinin, ku kam marrë pjesë edhe unë, drejtori i DSHPE, shefat e GP, Jeton Shabani dhe Mustafë Shehu. Pyetje decidive ia kam bërë kryeshefit se kam raporte dhe takohem shpesh me të, çështjen e menaxhimit të ujësjellësit, na tregoni se kush është përgjegjës. Ai e ka pranuar se janë përgjegjës. Me shifra rritjen e kapaciteteve mundem me shifra me ua dhënë, se janë investuar diku 400 mijë euro gjatë këtij mandati, dhe janë burimet e gatshme dhe ia kemi bartur kompetencat se është me rregullore që me pasur një kompani e licencuar për menaxhimin e ujit, e kjo është bifurkacioni, e ne ia kemi dorëzuar asaj. Ne nuk kemi qysh me menaxhuar ujin, se janë në kompetenca të bifurkacionit.

**z. Naim Beça:** Investimet a janë për ujë sipërfaqësor apo për ujë të pijshëm?

**Nënkyetari i Komunës:** Në Bajnicë dhe Ivajë për ujë të pijshëm, shtim të kapaciteteve të ujit nga burimet në luboten, por edhe burimet alternative që kanë qenë me ujë sipërfaqësor, për pikun e zhegut, se paku për higjienë. Plus janë shtuar edhe burime tjera 2 bunarë nga një organizatë amerikane, edhe 2 bunarë janë të Saniteksi, nuk janë në funksion, kështu nuk kemi çka me bërë me shumë.

**znj. Ardit Rrahmani:** Ne jeni të zgjedhur me i ngritur këto probleme, dhe mendoj që KK është adresa e duhur që qytetarët e shohin që po i ngiti këto shqetësimë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kam qenë pjesë e atij takimi edhe unë, dhe krejt ato që po i thoni janë shqetësimë të krejt qytetarëve, nuk janë veç të juaja apo tonë, se edhe ne kemi familjarë që vuajnë për ujë, krejt e kemi një qëllim për këtë çështje. Në takim unë kam qenë me radikal aty, ai ka thënë, në bazë të analizave, statistikave dhe prurjeve që po na vijnë, nuk keni me pasur problem për ujë.

**znej. Ardit Rrahmani:** Ata kanë thënë që 30 qershori ka me qenë dita kur ne kemi me qenë në rregull me ujin.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ka qenë parashikim i kryeshefit të Bifurkacionit.

**znej. Ardit Rrahmani:** Ekziston procesverbali.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në atë takim është thënë se, nëse vazhdon ky trend, nëse vazhdojnë këto prurje, janë zotuar se sivjet nuk kemi me pasur problem. Ky ka qenë konkluzion dhe ne jemi pajtuar me të.

**z. Naim Beça:** Ju është dashur me kërkuar kushte, dhe me i thënë se në muajin korrik në vitin e kaluar nuk kemi pasur ujë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** I kemi thënë edhe me shumë se ju që po i potenconi këto.

**znej. Ernesta Krasniqi:** Në vit elektoral, çka folët, janë vetëm pretime.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pyetje dhe kërkesa tjera nuk ka, kalojmë në pikën vijuese:

2. Raporti Gjashtëmuajor financiar për periudhën: Janar-Qershori 2025;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, ZKF Valdrin Dogani është këtu për sqarime. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Raporti financiar është një dokument që tregon nivelin e realizimit të buxhetit, dhe seriozitetin e ekzekutivit në përbushjen e objektivave për 6 mujorin e parë të vitit 2025, ku tregon qartë cili është planifikimin dhe realizimin i ekzekutivit. Në këtë raport ka një diskrepancë të madhe në mes të planifikimit dhe realizimit. Buxheti i komunës krijohet nga GQ dhe nga të HVK. Të HVK 33.22%, nuk e ka arritur atë që ka planifikuar. Pos kësaj, ka dështuar edhe në IK dhe MSH, d.m.th. nuk ka arritur me realizuar planifikimin. Të Shpenzimet, MSH, të mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe rurale, 282 mijë euro të shpenzuara për 6 muaj. Pajtohem për sezonin e dimrit se ka të reshura atmosferike, këto mjete janë shpenzuar në tre muajt e parë, ndërkaq në tre muajt e dytë, nga 125 mijë euro përafërsisht janë shpenzuar në

mirëmbajtjen e rrugëve, ndërkaq ne e dimë se në çfarë gjendje janë rrugët, në gjendje të mjerueshme sa i përket pastrimit, gropave, kjo donë sqarim me të gjerë. Pos kësaj, të ky projekt, është edhe një projekt tjetër, mirëmbajtja rutinë, të shpenzuara 70 mijë euro. Të ky projekt a hynë prapë pastrimi i rrugëve, nëse po, del se në total janë shpenzuar 350 mijë euro në mirëmbajtje të rrugëve për 6 muaj. Me shumë po shpenzohet në mirëmbajtje sesa në asfaltim të rrugëve. Me llogari komuna ka pasur me i shtruar këto rrugë, sesa me i mirëmbajtur. Të IK, ka qenë lehtë me investuar se e ka pasur buxhetin, kodet buxhetore, vetëm është dashur me zhvilluar procedurat e prokurimit. Në këtë rast keni dështuar, keni gabuar edhe në tabela, e kam thënë edhe në raportin 3 mujor, po e citoj” Sipas këtij raport thuhet, nga 3 milion e 500 mijë, 1 milion 678 mijë, gjë që nuk është reale kjo. Ik janë bërë vetëm 30 % afér 1 milion, pjesa tjetër janë me vendime gjykatave për kontratën kolektive dhe vendime tjera.

Nëse ju e shihni të arsyeshme që vendimet e gjykatave të hynë në IK, është gabim, se investimet kapitale duhet me i pasqyruar në mënyrë reale. Shembull: Ndërtimi i Aneksit të shkollës “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” janë planifikuar 200 mijë euro, këtu thuhet se janë shpenzuar 200 mijë euro, por projekti nuk është realizuar, objekti nuk ekziston, nëse qytetarët shkojnë me shikuar. Rrugët tjera, rruga “Hamëz Jashari”, segmenti i rrugës Silcapor-Rakaj, janë planifikuar 50 mijë euro, 40 mijë janë shpenzuar, kjo nuk është reale, se rruga nuk është ndërtuar. Të MSH kam një pyetje: Të mirëmbajtja e rrugëve ku thuhet se 270 mijë euro janë nga shërbimet publike, nuk e kam kupuar 11 mijë euro që janë bërë prej administratës. Të Subvencionet dhe transferet, kërkoj sqarim, të DSHPE, të BIK, pagesat për 25675 euro, ne dimë se për këto është marrë një vendim, dhe kjo duhet të jetë si kod buxhetor, e jo si subvencion.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtori i DSHPE Ramadush Osmani dhe drejtori i DBF Bahri Selimi nuk janë këtu, puna e tyre lidhet drejtpërdrejtë me raportin, do të ishte jo etike dhe jo njerëzore nëse nuk do i përvendosja sot dhe t'i falënderoj për gjithë punën e tyre në emrin tim dhe në emrin e juaj, se bindjet politike janë diçka tjetër, se në fund të fundit ne jemi njerëz dhe duhet të falënderojmë gjithsecilin për gjithë kontributin që kanë bërë, pavarësisht se dikush ka qenë i kënaqur apo jo, sinqerisht i falënderoj dhe iu uroj sukseset në rrugëtimin e tyre të mëtejmë cilido që të jetë.

**z. Bashkim Luma:** Meqenëse Agimi i përmendi pjesën me të madhe të atyre që i kisha si pyetje. Të shpenzimet komunale, mendoj se duhet të ketë një sqarim të duhur shpenzimet e mbeturinave. Totali i TM2 në vitin 2025 në krahasim me TM2 të vitit 2024, është 83%, ku shpenzimet janë rritur nga 9600 euro, në 16600 euro?

**znj. Arditia Rahmani:** Faleminderit Valdrin që je këtu për me na dhënë sqarime, meqë edhe në KPF na janë përgjigjur edhe Valdrini edhe drejtori i financave, të cilit i uroj sukses kudo që vazhdon. Diskrepanca mes planifikimit dhe realizimit, po flas për inkasimin e të HVK sipas drejtorive, ku këtë vit janë planifikuar të TP 350446 euro, realizimi 74 mijë për 6 muaj, që është shumë i dobët. Në anën tjetër, të taksat komunale për leje ndërtimi, planifikimi 267149 euro, 7240 euro realizimi. Për mua kjo është e pakuptueshme, qysh munden me u planifikuar kaq shumë taksa komunale për leje ndërtimi, pasur parasysh që nuk kemi PZHK, se nuk mundesh me dhënë leje pa PZHK, për atë realizimi është tejet i ulët. Për vitet tjera lë të jetë thirrje kushdo që ka fatin me udhëheqë komunën, planifikimi të bëhet me korrekt.

**zpj. Kadrije Lika-Troni:** Të HVK sipas drejtorive, të DUKMM, vazhdimisht kam kërkuar me ndarë kjo rubrikë, ku shënohen taksat tjera administrative dhe të shënohet se cilat taksa janë aty. Për këtë 6 mujor janë 125170 euro taksa tjera, krahasuar me vitin 2024, kanë qenë 29,562 euro. Këto vlera të pagesave janë taksa të qytetarëve, por unë si anëtare e KK, gati po përfundoj mandatin 4 vjeçar, pa e ditur për çka paguajnë qytetarët. Të ndihma çasti, janë 16,200 euro, pyetje për kryetarin, qysh po bëhet ndarja e tyre, a në baza partiake, apo bëhet për ndihmë sociale që iu nevojitet? Komisioni a është duke e kryer punën si duhet, se ka individë në nevojë, për ndihmë çasti, dhe janë kthyer pa iu ndihmuar? Unë kam ankesa, se në rast është kjo shumë 16,200 euro me mirë e shoh si subvencion për pagesë të rrymës, se nëse i llogarisim 16,200

euro, kanë përfituar 162 qytetarë nga 100 euro. A janë përfshirë pjesët rurale apo është përfshirë vetëm qyteti, se ne nuk po kemi njohuri ku kanë shkuan këto mjete? Këto janë taksa që ju e keni të drejtë me i shpërndarë, por nuk po kemi raport me ditur se ku kanë shkuan, a janë përfshirë qytetarët nga krejt vendbanimet dhe a kanë shkuan të nevojtarët, pa i ditur me emër dhe mbiemër?

**z. Rrustem Zenuni:** Unë edhe në mbledhje të KPF e kam potencuar se të HVK të tatimi në tokë, ka pasur një ngritje, ndërkaq ulje ka pasur të tatimi në pronë. Unë i kam pasur shqetësimet e mia që vendimi nga niveli qendror për heqjen e kushtit si kriter për regjistrimin e automjeteve, ka ndikuar dhe po iu paraqet problem komunave në inkasim te të HVK. Tjerat janë në rregull. Arsyja pse të IK ka shpenzime nuk ka realizime, dihen, janë si rezultat i kontratës kolektive, për mua kjo është e qëllimshme, për të tjerët nuk e di si është.

**z. Valdrin Dogani-ZKF:** Po fillojë me përgjigjet nga fundi që u ngritën prej Kadrijes. U ngrit si shqetësim të HVK të DUKMM. Ne i kemi kodet që i kemi paraqitur, që janë taksa të rregullta që janë me të theksuara, taksa për leje ndërtimore, taksa për leje mjedisore. Këto i kanë faturat e tyre, por janë do taksa tjera, që ju vet e keni miratuar në KK rregulloren për taksa, që nuk kemi mundur krejt me përfshirë, janë taksat tjera. Rregullorja për taksa janë të ndara në secilën drejtori se çfarë taksash inkason. Të pyetja për ndihma çasti, mbeti të përgjigjet kryetari. Të pyetja e Arditës, të HVK bëhen sipas planifikimit i cili planifikim bëhet në vitin paraprak. P.sh. ne e bëjmë planifikimin në vitin 2024 sesa kemi me i planifikuar në vitin 2025. Ne në vitin 2024 është parapa me u miratuar PZHK, por nuk është bërë. Janë paraparë taksat për leje ndërtimi, është parapa me lëshuar leje ndërtimi, por nuk janë bërë, për atë kemi shifër në vlerë të vogël numerike. Të Shpenzimet komunale, Bashkimi pati shqetësim për shpenzime të mëdha. Ndodhë që fatura e qershorit vjen në korrik apo ajo e dhjetorit vjen në janar dhe paguhet në këtë 6 mujorin e këtij viti. Ka mundësi që fatura e vitit 2024 ka ardhur me herët dhe e kemi paguar. Edhe çmimet për disa njësi janë rritur. Të pyetja e Agimit, të HVK që janë të vogla, edhe neve na shqetëson ky fakt, po kanë ndikuar shumë çështja, ndryshimi i ligjit për TP, zbritja për banim parësor, ka qenë 30 mijë është bërë 15 mijë. Të tatimi në pronë, tatohet pronari për atë objekt, në bazë të vlerës së objektit. E kemi heqjen e kushtëzimeve që e përmendi Rrustemi, si për regjistrimin e faturave, dhe për shërbime kadastrale që ofrohen. Rënia e taksave ë lejet e ndërtimit, në mungesë të PZHK. Të administrata e përgjithshme, është aktivizuar sistemi "e-Kosova", ku shumë qytetarë nxjerrin dokumentet vet. Të pyetja e 2 e Agimit, shpenzimet për mallra e shërbime për mirëmbajtjen e rrugëve, janë tre kontrata aktive, nuk është vetëm përrugë. Është kontrata për mirëmbajtje të rrugëve, kontrata për shenjim të rrugëve, dhe ajo për ndriçim publik, se është ligji përrugët i përfshinë, shënjin, ndriçimin dhe mirëmbajtjet tjera, heqje të dheut, asfaltet. Të mirëmbajtja rutinë janë 2 kontrata, mbylljen e deponive ilegale dhe mirëmbajtjen rutinë që e kemi me Pastërtinë. Të IK e kemi diskutuar edhe në KPF, ku janë sqaruar shpenzimet për IK është bërë shpalosje në faqen e fundit për mjetet e shpenzuara sipas kontratës kolektive.

**z. Agim Mani:** Nëse ndahen IK, e kuptojmë sesa ka IK të shpenzuara për këta 6 muaj. Sipas tabelave të paraqitura, del se për IK janë shpenzuar 1 milion e 600 mijë, por realisht nuk është kjo shumë e shpenzuar për IK, se aty janë edhe shpenzimet në bazë të vendimeve të gjykatës. E kam thënë, po e themi përsëri se nuk mund të quhen investime kapitale shpenzimet e realizuara në bazë të vendimeve të gjykatës.

**z. Valdrin Dogani-ZKF:** Në financa, vendimet e gjykatës i kemi si kod ekonomik.

**z. Agim Mani:** Sqarimet u dhanë, por tabelat duhet me i ndryshuar.

**z. Rrustem Zenuni:** Bashkimi kërkoj sqarime për shpenzimet të kompania "Pastërtia", por ne kemi një komision të aksionarëve këtu, ku Bashkimi është pjesë e atij komisioni që mbikëqyrë bordin-menaxhmentin. Ka qenë mirë me ushtuar atë të drejtë dhe me kërkuar edhe aty llogaridhënie se ta jep ligji atë të drejtë, keni mëditje që për mua ka qenë shqetësuese ajo

mëditje se i kushton bukur shumë kompanisë "Pastërtia. Ka qenë mirë edhe neve me na njoftuar me raportin, se për atë janë komisionet, me i mbikëqyrë bordet, ndërmarrjet publike.

**z. Bashkim Luma:** Rrustem ishim duke folur për shpenzimet komunale dhe është e drejtë e secilit prej anëtarëve të KK nëse është apo nuk është aksionar aty. Ndryshimet aty ishin nga 2024 në 2025, aty nuk ka të bëjë me kompaninë "Pastërtia", por me shpenzimet komunale. U kërkuar sqarim pse ky dallim kaq i madh i shpenzimeve. Njëra prej përgjigjeve ishte se është rritur shuma e pagesave, për 1 euro, por shpenzimet janë përgjysmë me tepër. Sqarimi tjetër është me në rregull, por nuk ka kuptim nëse TM2 2024 me 2025 që shkruhet në tabelë, nëse pagesa nuk realizohet brenda këtij afati. Atëherë të paraqitën shpenzimet komunale 1 vjeçare, e jo kështu të ndara.

**z. Rrustem Zenuni:** Kur të jeni përgjegjës për diçka, duhet me qenë i vetëdijshëm, se paku raportet financiare ndërmarrja i përcjellë edhe të komisioni edhe të bordi.

**z. Bashkim Luma:** Drejtori i DSHPE, tani ish drejtori që ka dhënë dorëheqje, ka qenë kryetar i bordit, që përfaqëson komunën e Kaçanikut. Sa i përket KK, unë kam bërë kërkesë të drejtori, që sot nuk është këtu fatkeqësisht, ne edhe vjet nuk kemi mbajtur mbledhje të bordi atje në Ferizaj, është viti i dytë që nuk kemi mbajtur mbledhje, ndërkaq kemi bërë kërkesë.

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi:** Sa i përket pyetjes së Kadrijes, është pyetje shumë me vend, edhe për mua është shqetësuese, se është rritur shuma për ndihma. Ne jemi munduar me i mbështetë sidomos ata që janë me sëmundje të rënda. Edhe tani i kam diku mbi 70 kërkesa të pa miratuar në mungesë të buxhetit. Është problem me myllur se kemi një numër të konsiderueshëm që vijnë me diagnozë. Nëse mendohet se ka ndonjë dyshim, se mund të ikë ndonjë rast, e kam zyrtarin Avdi Vërbani, lirisht ulemi e bisedojmë, dhe nëse ka ndonjë kërkesë që nuk është miratuar, unë ndjejë keqardhje, se ekzistojnë një kategori e personave që meritojnë me tepër se këto mjete, por mundësitet buxhetore janë të kufizuara.

E kemi një shumë që nuk ka qenë vitet tjera, se ka qenë iniciativë e f. Kotlinë, për me riparuar varrezat e civilëve në oborr të shkollës, dhe ata kanë kerkuar me iu ndihmuar diçka. Për secilën viktimë civile në Kotlinë, i kemi ndihmuar familjen me 400€, përndryshe kemi shumë kërkesa. Kemi shumë kërkesa, por në mungesë të mjeteve me iu ndihmuar, disa kërkesa përsëritën, ka edhe kërkesa të reja. Ndarja e mjeteve bëhet 300-500e jo siç ishte 100-200, por nuk e di a do të arrijë të përbushi.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, raporti është sa për njoftim, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës,

#### NJOFTOHET

**Me Raportin Financiar për periudhën: janar-qershori 2025/ Lënda: 01Nr. 400/01-16463/25.**

3. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2024;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, është një dokument që trajton çështjet financiare në komunë. Shumica e komunave sivjet e kanë një raport të tillë, për shkak të kontratës kolektive. Nëse ka kush diçka, urdhëroni:

**z. Ernesta Krasniqi:** Kërkoi sqarim për një paqartësi: Në bazë të mostrave të testuar, janë vrenjur se në tre raste janë kryer pagesat nga fondet e projekteve të aprovuar të buxhetit në vitin 2024, për projekte të tjera. Kontrata për ndërtimin e objektit social të banimit është nënshkruar në vitin 2022, në vlerë 406 mijë euro, projekt i nuk është realizuar në tërësi në vitin 2022 dhe 2023 dhe si rezultat i kësaj, në vitin 2024 komuna ka paguar shumën 30 mijë euro, duke shpenzuar fondet e projektit, furnizimi me aparatura për QKMF. Cilat aparatura bëhet fjalë që janë shpenzuar mjetet? Po ashtu komuna ka bërë pagesë për të njëjtin projekt 30 mijë euro, duke i shpenzuar mjetet për blerje të veturave për kujdesin parativ. A është blerë veturat dhe cilat aparatura janë mungesë në QKMF që u morën mjetet për këtë projekt? Tjetra, ndërtimi

i objekteve për banim social, a është për dy objektet apo vetëm për objektin e nënshkruar në vitin 2022?

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Pjetje, sipas gjetjeve të auditimit, kemi vërejtur se janë bërë pagesa nga kodet joadekuate, 458, 448 euro, pagesa për paga jubilare, shujta dhe kualifikim për arsimtar, janë kualifikuar si investim kapital mallra dhe shërbime, komunale dhe subvencione. Si i justifikoni tejkalimin e rregullës financiare që kërkon kodet adekuate për çdo shpenzim, kur shuma e 458, 448 euro janë klasifikuar gabim duke cenuar saktësinë e raportimit financier dhe besueshmërinë e buxhetit. Gjithashtu për buxhetin e DUKMM, nga mostrat e testuar në 4 rast, punimet nuk janë realizuar në pajtim me planin dinamik siç parashihet me kontratë: Ura mbi lumin nerodime, 79, 961 euro, vonesë 207 ditë, Nënkalimi urban, 210, 97 euro, vonesë 524 ditë, Rregullimi i sheshit i qytetit, vonesë 332 ditë, Trotuari "Murat Lika" 248 ditë vonesë. Çfarë masash konkrete janë marrë ndaj operatorëve ekonomik që vonuan punimet deri 524 ditë, duke shkaktuar humbje kohe, dhe besim të infrastruktura publike. Në vitin 2024, komuna nuk ka bërë asnje inspektim të 20% të pronave të paluajtshme, siç është e përcaktuar me ligjin në fuqi të tatimit në pronë. Pse nuk u realizua asnje verifikim i 20% i pronave, duke mos respektuar kërkesat ligjore për transparencë dhe menaxhim të pasurive komunale?

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është hera e parë që kemi një raport të tillë të auditimit.

**z. Naim Beça:** Pjetje për Ekzekutivin: A jeni të kënaqur me raportin e auditimit, a e keni marrë si raport pozitiv apo si raport negativ?

**Kryetari i Komunës:** Nuk jemi të kënaqur, ndërkaq sa për informacion, vetëm një komunë e ka raportin mirë, nëse nuk gaboj është Rahoveci apo Klina, se i kanë paguar me herët obligimet ndaj kontratës kolektive. Gjetjet janë Kadrije, por nuk e prishë opinionin, ajo që ka prishë opinionin është kontrata kolektive, që edhe këtë vit mundet me prishë. Ne kemi menduar se është 5%, por ishte 1% nëse e kalon shumën buxhetore. Nëse buxheti është 11 milion, nëse e tejkalon 1 milion, e prishë opinionin. I kemi pyetur edhe auditorët dhe na kanë dhënë këtë sqarime, se e kemi pasur 1% tejkalim me kod buxhetor adekuat.

**z. Naim Beça:** Po ndalem të transparenca, Unë e pata bërë pyetje, A ka projekte që janë në zhvillim e sipër. Përgjigja ka qenë me shkrim (email) me një injorancë shumë të madhe, Jo nuk ka. Kurse rapporti i auditimit na jep se ka pasur deri 524 ditë vonesa për sheshin që do të thotë transparenca nuk ka qenë në rregull, se ka qenë pa përfunduar sheshi, parku etj., ndërkaq përgjigjen me shkrim e kemi marrë se nuk ka projekte të papërfunduara.

**znj. Arlinda Rakoci-Raka:** Në raportin e auditimit janë identifikuar fusha që kërkojnë përmirësimin në menaxhimin financier, si pagesa pa buxhet, vonesa në përfundimin e kontratave dhe obligimeve pa mbulesë financiare. Në 12 rekomandime, 6 prej tyre janë të reja, pjesa tjeter të përsëritura nga viti i kaluar, që tregon se problemet po vazhdojnë. Këto gjetje duhet t'i shqetësojnë, sepse tregonjë dobësi në menaxhimin e parasë publike dhe mungesë të zbatimit të rekomandimeve të mëhershme.

**z. Agim Çaka:** Gjetjet të cilat janë në këtë raport janë mjaft serioze dhe ndërlidhen me keç menaxhimin financier. Në këtë raport shihet se 6 gjetjet nga viti 2023 pos që nuk janë përmirësuar, janë shtuar edhe 6 gjetje tjera në vitin 2024. Kjo tregon se nuk është punuar mirë. Gjetjet bëhen ose me qëllim të mashtimit ose nga padituria. Sipas mendimit tim, të dy llojet e gjetjeve janë të pa pranueshme, por kjo me qëllim të mashtimit është me e rrezikshme.

**z. Agim Mani:** Sado që po thirremi në transparencë, auditori i qet në pah parregullsitë. Në bazë të këtij rapporti, opinioni i auditorit është i kualifikuar- opinionin është i keq. Ne zakonisht e kemi thënë, po nuk na keni besuar, mundeni mos me i besuar as raportit të auditimit, por kjo

është gjendja faktike në komunën tonë. Komuna e Kaçanikut gjatë realizimit të buxhetit, ka shpenzuar 458, 448 euro nga kategoria ekonomike jo adekuate, afër gjysmë milioni euro.

**z. Valdrin Dogani:** Agim, nuk po e lexon atë që thesari i kishte paguar.

**z. Agim Mani:** Gjetjet dhe rekomandimet, ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, 6 janë të reja, 6 të përsëritura. Identifikimi tek menaxhimi i kontratave publike është bërë, nuk ka menaxhim të mirëfilltë të kontratave publike. Hyrje në obligime kontraktuare në mungesë të buxhetit, këto janë shkeljet. Mungesë të projekteve ekzistuese, vonesë në përfundim të punimeve të kontraktuara, vonesë në pagesë të obligimeve financiare. Të kjo e fundit, po ndalem, se për shkak të vonesave, komuna është detyruar të paguaj 110, 758 euro për shkak të vonesave të pagesave faturave në mungesë të mjeteve, apo si rezultat i vonesave, po thuhet se komuna ka paguar gjobë 110 mijë euro. A janë pak për buxhetin tonë këto mjete? Zbatimi i rekomandimeve ka qenë me i lehtë, nga testi i rezultuar që ka thënë auditori, unë po i drejtohem kryetarit, për projekte kapitale, nuk ishin të përgatitura projektet ekzistuese. Është fjala për, projektet për rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale dhe urbane. Janë hapur procedurat tenderuese, pa projekte. Kjo ka qenë e lehtë me u realizuar se rrugët janë shtruar, vetëm projektin me e bërë, por nuk e keni bërë as të ndërtimi i depos të QKMF. Edhe në vitin 2025, keni vepruar njëjtë, nuk keni bërë projekt dhe nuk e dini në cilën fazë është tanë asfaltimi i rrugëve, nuk e dini cilat rrugë kanë me u shtruar, se nuk keni projekt, se keni vetëm paramasa. Këtë e përdorni në fushatë, se mundeni dhe keni vepruar edhe në të kaluarën që këto rrugë i shtroni nga doni ju.

**z. Rrustem Zenuni:** Është normale që nuk na vjen mirë opinioni i kualifikuar i auditorit, shakatarë kryesor është kontrata kolektive. Edhe në vitin e kaluar raporti i auditimit ka pasur të gjetura, nga pak, por ju keni pasur të njëjtën qasje, të njëjtin vlerësim, të njëjtin përfundim, ndërkaq asnijëherë nuk e keni thënë se ne me atë raport kemi përfituar mbi 800 mijë euro GP. Fakti kryesor që është ky raport, është kontrata kolektive, e jo pse nuk ka punuar mirë komuna. Ju edhe mirë me qenë raporti,asnijëherë nuk pajtoheni, ndërkaq për të keq, jeni të parët që dilni me parulla. Është mirë mos me ua humbur mundin zyrtarëve këtu që punojnë, as ekzekutivit e as neve këtu që vijmë e kontribuojmë me mundësinë që kemi. Sa i përket Ernesta juve, unë e di që ju nuk keni asnje lloj aftësie me vlerësuar raportin e auditimit.

**znj. Ernesta Krasniqi:** Rrustem kush jeni ju me mi treguar aftësitë e mia? A e dinë që askush nuk merret me juve, as nuk të merr parasysh fjalën tënde.

**z. Valdrin Dogani:** Përgjigje për Ernestën: Fillimisht për pagesat në kundërshtim me buxhetin, i kemi pasur të tenderuar, furnizimin me aparatura për QKMF dhe blerja e veturave për kujdesin paliativ, por kanë dështuar procedurat. Çështja është, pse me i lejuar ato mjete me u kthyer, kështu i kemi shpenzuar me një kontratë tjetër. Ne i menaxhojmë kontratat dhe e shohim sesa kemi obligime, ndërkaq kanë dështuar se ka pasur ankesa në prokurim. Ne nuk e kemi obligim me kërkuar me u kthyer mjetet, kur i dimë obligimet e kontratës kolektive.

Çështje që ndikojnë në opinion të auditimit janë dy: 1. Klasifikimi adekuat i shpenzimeve, këtu janë ekzekutuar pagesa nga thesari, nuk janë pagesa që ne i kemi bërë vullnetarisht. 2. Mos regjistri i pasurisë në sistem kontabël.

Çështjet tjera janë që nuk e kualifikojnë opinionin e auditorit, por janë gjetje, që auditori e ka për detyrë me i gjetur ato parregullsi, që mos me i përsëritur. Në vitin e kaluar i kemi pasur 14 të gjetura, tanë i kemi 12, 6 prej tyre janë të reja, 6 të përsëritura. Gjetje të reja janë me A1, A2, A 3, të përsëritura janë me B1, B2, B3. Pas kësaj pike e kemi planin e veprimit për hapat që do ti marrim për zbatimin e rekomandimeve. Përgjigjet tjera, i arsyetojnë menaxherët e kontratave. Të çështjet financiare, pyetja për keç klasifikimet, pagesat janë ekzekutuar prej thesarit, ti tërheq mjetet prej një projekti dhe neve na e prishë planifikimin e buxhetit.

**Kryetari i Komunës:** Sa i përket pyetjes Agim të projektet: 1. Të projekti i QKMF për garazhin, projekti ekziston, ka qenë një mangësi ku ata e kanë kërkuar, nuk e kanë përcjellë përmes emailit dhe ata kanë llogaritur se nuk ekziston, edhe pse me vonë kemi insistuar por nuk e kanë besuar. Nëse nuk besoni, shkoni të firma, e shihni projekti për garazhin është i gatshëm. Sa i përket rrugëve urbane dhe rurale, kjo ka me u përsëritur edhe shumë vite, se ne kemi rrugë 20m, 30m, 50 m, kështu me bërë projekt për këto rrugë nuk e bëjmë ne as nuk ka për të bërë askush. Ata e kërkojnë me letër, por kur të paguhen, precizohen në pagesa se ku janë paguar. Ata kanë kërkuar projekt detal, ne nuk kemi projekt detal për rrugica. Ndërkaq rrugët që i kemi me kode të veçanta, janë me projekt, tenderojmë, ndërsa për rrugët e shkurtata dhe të trotuari është e njëjtë situatë, kanë me na u përsëritur kështu një kohë të gjatë.

**z. Agim Mani:** Kjo është një qasje e gabuar, asfaltimi i rrugëve bëhet pa projekte. Duhet me pasur emrin e segmentit të rrugës, por nuk i keni segmentet e rrugës që keni me i shtruar, por vetëm me paramasa. Tjetra, vonesa e pagesave të obligimeve financiare. A ka paguar komuna 110 mijë euro, për shkak të vonesave të pagesave.

**Kryetari i Komunës:** Në prokurim kur të hapet tender, nuk hynë emrat, në kod është rrugët lokale, nuk shkruan, por në pagesa krejt janë me emra të rrugëve.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatohet se Kuvendi i Komunës,  
**NJOFTOHET**

**Me Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës së Kaçanikut, për vitin 2024;/ Lënda: 01Nr. 470/03-16585/25.**

**4.** Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për PFV 2024;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kjo është informatë, që drejtoria e njofton KK sesi ka me i zbatuar rekomandimet e dhëna në raportin e auditorit. Nëse ka kush diçka urdhëroni:

**z. Agim Mani:** Ky plan i veprimit që e keni sjellë është mirë me u realizuar, se nëse nuk realizohet, atëherë dështojnë zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga rapporti i auditorit. Mirëpo i njëjtë plan ka qenë edhe vitin e kaluar, e kemi përkrahur, por 6 gjetje nuk janë realizuar. Për kundër asaj, ne po ia japim mbështetjen tonë që të kalojmë si plan, të merrni seriozisht rekomandimet e dhëna në raportin e auditorit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Raporti është sa për njoftim, nuk votohet. Diskutime tjera nuk ka, atëherë, konstatoj se Kuvendi i Komunës,

**NJOFTOHET**

**Me Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, për PFV 2024/ Lënda: 01Nr. 470/03-16588/25.**

**5.** Raporti Gjashtëmuajor i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2025;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, raporti është në vija të trasha që KKSBB i raporton KK. Nëse ka kush diçka, urdhëroni:

**z. Burim Shehu:** Të pika 9, thuhet: Të punohet me tepër në zgjidhjen e kamerave të sigurisë. A është punuar, dhe kush i ka kompetencat në mbikëqyrjen e kamerave, policia apo komuna, se ka qenë në dilemë kjo çështje? Janë edhe dy tjera, të respektimi i ligjit në komunikacion, a keni bërë diçka që rrugët që është kërkuar me u shtuar gropat, zebrat janë fshirë, a keni bërë diçka në këtë drejtim? Kamera sa i di unë janë 80, ndërkaq funksionale është thënë se kanë qenë vetëm 23.

**z. Ardit Rrahmani:** Asnjë kamerë nuk është funksionale.

**Kryetari i Komunës:** Sa i përket kamerave, është hapur tenderi që 2 herë, por ka dështuar, ndërkaq sa janë funksionale kamerat e qytetit, nuk e di, se ato i menaxhon policia. Ne tenderin e hapim për kamerat e sigurisë që janë në menaxhim të komunës, si shkolla, ambulantë, shtëpia e kulturës. Ne kemi dashur në kuadër të kësaj me ndihmuar edhe për ato tjerat, kemi kërkuar nga MPB me bërë një zgjidhje të përhershme, se krejt komunat e kanë këtë shqetësim, auditori ua shkruan shkelje, për shkak të mirëmbajtjes që munden me u bërë në forma të ndryshme, sikur ne që jemi duke u munduar me bërë. Këtë nuk e kemi obligim ligjor, por e kemi obligim moral, por auditori nuk po e merr parasysh, kemi mundësi me i bërë aty ku mendojmë. Ndërkaq sa i përket gropave, këtë vit kemi menduar me ndarë mirëmbajtjen verore dhe dimërore, për shkak të çmimeve. Të mirëmbajtja dimërore e kemi obligim ligjor, të këto tjerat po na neglizhojnë sa po duan. E kemi bërë një pjesë të gjobave, me gjithë presionin që 4-5 muaj, nuk kemi arritur me bërë. Janë dy gjëra, me shkëputur kontratën apo me vazhduar kështu. Prej këtij viti ky problem ka me u zvogëluar në masë të madhe.

**z. Agim Mani:** Vazhdimisht kam kritikuar këto lloj raportesh që na vinë në KK, për arsyet se ky raport është i mangët, në krahasim me informimin që duhet me ua bërë qytetarëve, apo neve si anëtarë të KK, për çështjen e sigurisë në komunën tonë. Në pamundësi që të sanksionohen KK që nuk është pjesë e KKSBB, mendoj se nuk është e mirë ajo, sidqoftë është një UA, se edhe opozita edhe KK duhet të janë pjesë e KKSBB. E vëtmja mundësi me u informuar KK është ky raport. Me 3 faqe raport është e pamundur të njoftohemi ne si KK dhe qytetarët për çështjen e sigurisë në komunën tonë. Janë cekur disa shqetësimë dhe rekomandime në takime që ka mbajtur KKSBB. Mbledhja e fundit është me 01.07.2025, ku KKSBB nuk e ka pa të arsyeshme të ketë një përkujdesje për zjarret, kur dihet piku i verës që ka mbajtur në komunën tonë, por nuk është diskutuar kjo çështje, nuk është diskutuar çështja e ujit të pijes.

**Kryetari i Komunës:** Sa i përket raportit, çdo herë e kemi sjellë në këtë formë. Prosesverbalet janë publike, kushdo që ka dashur me i pa. Sa i përket shqetësimëve, në çdo mbledhje të KKSBB është pika: Të ndryshme. Në këtë pikë ka të drejtë çdokush me ngritur shqetësimë. Ato që janë ngritur, janë dikutuar, ato që nuk janë ngritur, nuk janë diskutuar, por askujt nuk i mohohet e drejta me diskutuar për çështjet që paraqiten në kohë.

**z. Agim Mani:** Unë i kam diskutuar të gjitha procesverbalet, në ato procesverbale kanë dalë rekomandimet. Në cilat procesverbale shkruan zbatimi i rekomandimeve të dhënë, nuk shkruar në asnjë procesverbal, as në raport. Se paku rekomandimet e paraqitura nga KKSBB duhet të përfshihen në raport, ndërkaq a janë të zbatueshme apo jo, ajo është tjeter. Prosesverbalë e ka ecurinë e mbledhjes, ndërkaq rekomandimet, si çështja e kamerave të sigurisë, ju e dini kryetar që u bë temë shumë e madhe. A është zbatuar ai rekomandim apo jo? Nuk është zbatuar. Ka edhe shumë rekomandime tjera që janë nxjerrë, ndërkaq nuk e dimë a janë zbatuar apo jo.

**z. Naim Beça:** Mbledhjet që janë mbajtur në KKSBB, pika e parë është miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, mirëpo rezultatet e tyre nuk paraqiten askund. Nëse është diskutuar një pikë e rendit të ditës në një mbledhje, në mbledhjen tjeter duhet të jetë realizimi i asaj pike, por askund nuk shihet se është realizuar. Është çështja e vandalizmit si temë, çështja është, sa njerëz janë dënuar për vandalizëm, kjo lidhet me kamerat e sigurisë, kamerat e sigurisë ndihmojnë në hetimin e procedurave të tilla, por nuk ka të dhëna për këtë çështje. Nuk është paraqitur në raport, çështja e geneve endacak. Ka shumë qenë endacak, kjo është potencuar disa herë e kam përmendur edhe unë disa herë, që kjo çështje është një ndër çështjet me të rrezikshme. E dyta, çështja rreth limit nerodime, është alarmante, kam biseduar edhe me mijek, me kanë thënë se mundet me u përhapur pandemi. Kryetar, është rrezik permanent përhapja e pandemisë. A paraqet rrezik për siguri kombëtare pandemia?

**Kryesuesi i Kuvendit:** KKSB është i formuar prej KK, që mundet me dhënë informata shumë me të mira për këtë punë. Është Instituti kombëtar etj. që duhet me alarmuar këtë gjendje. E dyta, pjesë e punës e KKSB, ka raste kur natyra e problematikave është e natyrës penale, ka qenë në polici e gjykatë, që pastaj mundemi me i marrë vërdiktet e atyre organeve që i kanë marrë, të cilat janë edhe interne. Ato të cilat ne duhet që të diskutojnë, janë këto çështje, çështja e kamerave të sigurisë, pjerrinat e personave të hendikepuar. Ndërkaq vandalizmi etj. janë çështje të cilat duhet të trajtohen nga organet tjera.

**z. Naim Beça:** Mbledhjet që unë po diskutoj për pikat të cilat janë në raport. Nëse ka qenë pikë e rendit të punës: Roli i qytetarit në parandalimin e vandalizmit, kjo duhet me pasur njëfarë rezultati. A ka pasur persona të dyshuar për vandalizëm? Kur të raporton komandanti i stacionit, ne duhet me ditur sa persona kanë qenë të përfshirë. E dyta, çështja e bulizmit në shkolla, këtu duhet me pasur në raport të veçantë prej psikologës. Kjo është temë shumë e gjerë, me qenë me numrin e rasteve, jo me emra. Ka lloje të ndryshme të bulizmit, ne si prindër duhet me ditur këtë çështje. Pyetje: A hynë në çështje të sigurisë, shkallet e banesave- shkallët emergjente, se asnjëherë nuk u bisedua për këtë temë. Unë po ju zgjedh juve me i ngritur këto çështje.

**Kryetari i Komunës:** Sqaroj se komandanti i stacionit policor raporton për çështje të sigurisë. Unë nuk mundem me iu imponuar anëtarëve të KKSB me ngritë këtë temë apo atë temë. Është diskutuar çdo pikë veç e veç, kemi pasur psikolog, pedagog, ndërkaq sesa minden me u zbatuar, ajo është diçka tjetër. Naim, a me adreson me shkrim këto çështje, unë e ngriti këtë shqetësim në KKSB.

**z. Naim Beça:** Ka shumë pika që janë primare për çështjen e sigurisë, me i adresuar, ndërkaq bisedohet për çështje sekondare.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, Raporti i KKSB është sa për informim, konstatoj se Kuvendi i Komunës,

#### NJOFTOHET

**Me Raportin Gjashtëmujo i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2025/Lënda: 01Nr. 104/02-16593/25.**

**6.** Propozim Vendimi për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për komunën e Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Propozim vendimin e keni marrë se bashku me planin. E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Është mirë që është bërë një raport i tillë, megjithëse duhet vlerësimi i rrezikut të bëhet në të gjitha institucionet, mirëpo në këtë rast është bërë për shkaqe natyrore, mirëpo për me bërë një vlerësim të tillë, duhet një ekip profesional e profesionale të ndryshme. E pash një komision që ka marrë pjesë në ekip, mirëpo probabiliteti i rrezikshmërisë nuk është i njëjtë, por komisioni e ka dhënë një vlerësim të tillë. Në raport nuk e pash në raport një rezyme për masat e marra në bazë të rreziqeve. Raporti bëhet për një qëllim, marrja e masave nga ekzekutivi. Ekzekutivi për me marrë masa në afate kohore të realizimit, duhet të ketë edhe kosto buxhetore. A keni ndarë buxhet për çështjen e rreziqeve të fatkeqësive natyrore?

**z. Bujar Bajra:** Ky është dokument i vlerësimit të rrezikut, hartuar nga grupei punues prej 9 anëtarëve. Në fund janë dhënë rekomandimet, është edhe rekomandimi për masat parandaluese. Për momentin buxhet nuk ka të ndarë komuna, se nuk lejohet me u ndarë buxhet për asnjë komunë në Kosovë. Kjo është mangësi, besoj se rregullohet në nivelin qendror. Dokumenti është voluminoz me 298 faqe, plus është një aneks prej 40 arkave, janë skenarët për rreziqet që i kanosen komunës tonë, si: vërshimet, rrëshqitje të dheut, erërat, ortekët, pandemia. Ne edhe në pandemi kemi vepruar, edhe pse nuk e kemi pasur këtë vlerësim, në bazë të vlerësimit të vjetër, kemi vepruar dhe besoj se ka qenë suksesshëm, ka qenë edhe shtabi i formuar, ku kemi

vepruar edhe në shtab. Ky dokument është dërguar në MAPL dhe Agjencinë e menaxhimit të emergjencave për vlerësim profesional. Drita jeshile është marrë, ka mbetur vetëm miratimi në KK. ky plan është bazë për hartimin e të gjitha planeve emergjente në komunë, si hartimi i planit emergjent, plani operativ emergjent, plani për mbrojtje nga zjarri, plani i reagimit emergjent dhe për kompani tjera që duhet të shpërndahet, duhet të ndahet në kopje me punuar në bazë të këtij dokumenti dhe duhet me iu përbajtur. Ne e kemi theksuar, rekandimet, të metat, edhe shkallët emergjente edhe për hidrantët që i kemi në Glloboqiocë dhe Strazhë. Në Glloboçicë është të shkolla, skenarët janë për çdo rrezik, ndërkaq pa kosto nuk mundet me u realizuar plani. Në mundësitë tona, punët tona i kemi kryer, tanë i mbetet KK me vendosur.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Pyetje për Bujarin: Qysh qëndron komuna me kapacitete të stafit të trajnuar, me pajisje, a jeni në gjendje gatishmërie? Ne e dimë që i kemi zjarrfikësit për fikje të zjarrit, mirépo ne nuk e dimë a janë kryer trajnimet në stafin komunal dhe në të gjitha institucionet, është e nevojshme që kapacitetet e nevojshme me qenë në gjendje gatishmërie në çdo lloj rreziku që i kanoset vendit tonë?

**z. Bujar Bajra:** Pjetja është shumë me vend, kjo është mungesë përgjegjësie në krejt Kosovën, se zjarrfikësit kanë detyrë tjetër, ekipet për kërkim shpëtim kanë detyrë krejt tjetër, është mungesë e madhe si në Prishtinë dhe në çdo komunë tjetër. Edhe sot kemi mungesë të zjarrfikës, se janë 3-4 zjarrfikës në bazë, që për një zjarr me shuar, duhet me qenë se paku 3. Kush me mbetur me ndodhë zjarri i dytë. Mungesa është prej agjencisë të Emergjencave në Prishtinë, ata e caktojnë stafin, numrin. Besoj se kanë me bërë diçka në këtë drejtim tanë, se mungesë ka çdo komunë, por kjo nuk varet prej komunës.

**znj. Ardita Rrahmani:** Falënderoj z. Bajra për hartim e këtij dokumenti mjaft të rëndësishëm për gjithë komunën. Është mirë me lexuar të gjithë edhe pse është shumë voluminoz. E kam një pyetje, në pikën 8.2, f.296, ku thuhet, kostoja e financiare e dokumentit të vlerësimit në të janë të përfshira mjetet të cilat komuna i ka ndarë gjatë vitit 2024, për ndërtimin e shtretërve të lumenjve edhe planifikimi mandej që është edhe përvitin 2025 dhe 2026. Kam një pyetje, të shtretër të lumenjtë, a është në përgjegjësi të MMPHI, pse është dhënë kjo kosto, çka ka ndodhur, pse është dashur këto mjete me shkuar prej komunës, rrjedhjen e lumenjve nuk e përcakton komuna?

**z. Bujar Bajra:** Është projekt për ndërtimin e shtretërve të lumenjve dhe përroskave. Pastrimin e lumenjve edhe përroskave, ne kemi bërë kërkuesë në MMPHI dhe na është aprovuar kërkuesi që është edhe përvitin 2025 dhe 2026. Komuna me kapacitetet e saj, e ka pastruar lumenjve edhe përroskave, pse është dashur këto mjete me shkuar prej komunës, rrjedhjen e lumenjve nuk e përcakton komuna?

**znj. Ardita Rrahmani:** E vërtetë, por unë nuk e kam të qartë, ku thuhet për ndërtimin e shtretërve të lumenjve dhe përroskave përvitin 2024, janë ndarë 150 mijë euro. A janë ndarë këto mjete për ndërtimin apo për pastrimin e lumenjve dhe përroskave?

**z. Bujar Bajra:** Këto mjete janë për pastrimin dhe rregullimin, se çdo lagje janë të rregulluar shtretër të përroskave, janë mbi 15 përrenj që janë rregulluar. Këto janë kontrolluar nga agjencancia, na kanë lavdëruar pakëz, kështu me këshillat tona, drejtorinë dhe kryetarin, janë angazhuar përrrenjtë në çdo fshat.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Pjetje për z. Bajra. Kur u fol për pastrimin e lumenjve, pastrimi i lumenjve është në kompetencë të komunës për pjesën sa është në qytet. Kur jemi të lumi lepenc, mua në mes të palestrës sportive dhe stacionit të autobusëve, aty është një shelgje që iu ka dashur vite të tëra të kalojë urën, e cila është rritur aq shumë nga mosmirëmbajtja nga komuna e Kaçanikut, në rast se do të kishte vërvshime, sipas teje, çka do të ndodhë me ato shelgje e barishte që janë mbledhur aty. Kaçaniku i ka dy lumenjtë, jo vetëm lumin nerodime

këtu të korzo, e cila shihet sa për sy e faqe, vite të tëra iu kanë dashur një shelgje me u rritur me kaluar urën, ndërkaq kryetari, drejtori që nuk është këtu, nuk e kanë pa të arsyeshme me e pastruar, për hir të frekuentimit të vizitorëve që vijnë nga vende tjera si me autobus apo që vijnë për lojëra sportive, që ia ka dhënë një pamje të keqe qytetit të Kaçanikut.

**z. Bujar Bajra:** Në rast të vërvshimeve vjen deri të gufatje, uji del mbi urë, kërkesë iu ka bërë kompanisë, kompania do të del me pastruar.

**Nënkyetari i Komunës:** Arditë e ngriti çështjen që është ndërtim i përroskave. Është e vërtetë që për çdo vit kemi ndarë nga 150 mijë euro për ndërtimin e përroskave, e lumenjve që është me tepër në kompetenca të ministrisë. Është e vërtetë se është investuar të përroska të Kovaçët, Dallosh, ku si rezultat i ndërtimi i përroskave, largohet rreziku për vërvshime. Pastaj ka pas investime në Kovaçec, Stagovë, në shumë pjesë në qytet, të cilën mundemi me dokumentuar me vlerë të kostos financiare dhe me emërtime se ku kanë shkuar ato.

**z. Naim Beça:** Çdo plan që bëhet duhet me pasur një buxhet. Buxheti për këtë plan, nëse nuk shpenzohet, a bartet në vitin tjetër edhe a shtohet ai buxhet, nëse nuk shpenzohet krejt?

**z. Bujar Bajra:** Nuk ka pasur asnjë cent buxhet për këtë plan.

**z. Naim Beça:** Qysh doni me realizuar këtë plan, pa pasur buxhet? Ju e keni bërë një plan, ndërkaq nëse ndodhë ndonjë fatkeqësi, duhet përmes agjencisë në Prishtinë me t'i lejuar fjala vjen 2000 litra naftë, kjo nuk shkon kështu. Sa i përket përroskave, shterja e burimeve të përroskave, a ka ndonjë plan, se unë e di që në f. Runjevë ka pasur mbi 20 përroska, ndërkaq sot nuk e kemi asnjë. A ka ndonjë arsyë që janë shterë ato përroska?

**z. Agim Çaka:** Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave-AME me pas dhënë ndonjë vërejtje në këtë plan se nuk është në rregull apo nuk është në harmoni me legjislaturën në fuqi, ka pasur hapësirë për debat. Sa po e shoh unë, AME, pas shqyrimit profesional të përbajtës së aktit, vlerëson se dokumenti është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Grupi që ka punuar në këtë drejtim, e kanë pasur parasysh këtë fakt dhe kanë punuar dokumentin ashtu si duhet. Sa i përket çështjes se buxhetit, shpresoj të mos ndodhin masat që duhet me i marrë, besoj se komuna e ka parasysh që buxheti që planifikohet të ndahet në raste të fatkeqësive të pa pritura, të cilat mund të janë të pa parashikuara. Dokumenti mirë që është bërë në këtë formë dhe mirë që ka qenë i pranueshëm nga agjencinë.

**z. Bujar Bajra:** Naim, në plan janë të caktuara burimet alternative, në sekondë, sa kubik litra në sekondë, por edhe iniciativa e komunës për me pasur hapje të bunarëve në shkolla, shtëpi të shëndetit. Këto janë alternativa për çdo pjesë të fshatit etj., nga ajo çka kemi mundur me gjetur shënime me të freskëta. Plani ndoshta u vonua pakëz, për shkak të regjistrimit të popullsisë. Në përgjegjësi janë potencuar fatkeqësitë që mund të ndodhin dhe masat që mund të merren gjatë fatkeqësive.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtoj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Prezentë 22. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë

## VENDIM

**Për Aprovimin e dokumentit për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për komunën e Kaçanikut/ Lënda: 01Nr. 07-104/02-16621/25.**

7. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit të KK për shpallje me interes publik të parcelës kadastrale 00515-1 në ZK Kaçanik;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kjo është sjellë në KK, për shkak të një gabimi teknik, se është thirrur në një ligj dhe rregullore tjetër, ndryshimi është se duhet me u thirrur në një nen të një ligji

tjetër, është dashur me u thirrur në ligjin e shpronësimit, e jo në ligjin që është thirrur. E hapi diskutimin;

**z. Agim Mani:** Është hera e dytë që vjen kjo në KK, ne edhe herën e parë kemi qenë kundër, kur nuk e dimë cili është interes i komunës, për çka po shpronësohet kjo pronë? Ju e dini se në rrugën "Ismail Raka", ku kemi kërkuar me u zgjeruar rruga të banesat e Nasës, e cila ka qenë 18m, është ngushtuar në 12 m. Mendoj se këtu duhet të kemi parasysh, se buxheti e qeverisë, është për një projekt i cili ka me lidhur rrugën Runjevë-Stagovë- Kaçanik i Vjetër- Gërllicë, ka me u lidhur me autostradë, ka me lidhur fshatrat me Vitinë. Është një projekt madhor, mos të pengojmë edhe në këtë rast, se andej ka me kaluar kjo rrugë përmbrapa ETC. Plani i cili është duke u hartuar, ka me kaluar mbi atë rrugë. Duhet të kemi parasysh këtë çështje, që ju po e shpronësoni, se është një projekt madhor. Kjo rrugë ka me kaluar mbrapa ETC. Unë e bëra pyetjen se cili është interes i komunës për këtë shpronësim?

**Kryetari i Komunës:** Ajo që po thoni Agim, kjo rrugë është në tjetrën anë, gabim jeni, nuk është nga rruga që po thoni ju nga vjen rruga e Runjevë. Ne jemi duke bërë rrugë, ajo rrugë nuk lidhet me rrugën kryesore që lidhet me qytet.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është duke u bërë rruga me qarkulluar njerëzit. Edhe me ardhur ai projekt, pronën duhet me shpronësua.

**z. Agim Mani:** A ka plan komuna për atë rrugë? Ne e dimë që shpallja e interesit publik kur të bëhet, bëhet për një plan komunal. Komuna duhet me pasur projektin, buxhetin dhe me filluar procedurat për shpronësim. Komuna nuk ka as projekt, as buxhet për atë shpronësim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Vendimi është marrë, në KK ka ardhur tani për një ndryshim plotësimin e atij vendimi. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë e shtoj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 16 votë Për, Kundër ishin 4 anëtarë nga LVV (Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Bashkim Luma, Ernesta Krasniqi). Abstenim nuk ka. Prezentë 20. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë

#### VENDIM

**Për ndryshim plotësimin e vendimit të KK për shpallje me interes publik të parcelës kadastrale 00515-1 në ZK Kaçanik/ Lënda: 01Nr. 350/03-16798/25.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, Kryesuesi e konstatoj mbledhjen të përfunduar në ora 13:06. Nga 25 anëtarë të KK sa ishin pjesëmarrës në këtë mbledhje, deri në fund të mbledhjes qëndruan 20 anëtarë. Gjatë shqyrtimit të pikës 3 dolën anëtarët: Raif Kasa, Lejla Muhamheri-Çaka, ndërkaq Burim Shehu gjatë shqyrtimit të pikës 5, ndërkaq Naim Beça, Arta Avdiu nuk ishin në pikën 7.

Procesmbajtës

Makfire Malsiu

*JMalsiu*

Kryesues i Kuvendit

Kemal Mursej

